



22 janar 2013, Prizren

### KOMUNIKATË PËR MEDIA

#### **Kampingu në Prevallë: Jashtë PRrU-së, me kontratë të skaduar dhe defekte të shumta**

Në kuadër të projektit të monitorimit të transparencës së ekzekutivit komunal të Prizrenit, EC Ma Ndryshe në pjesën e parë të muajit janar ka vazhduar me shqyrtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me zhvillimet aktuale në Prevallë.

Pas ngritjes së shqetësimeve në muajin dhjetor për gjendjen e krijuar në fshatin turistik të Prevallës, ku ndërtimet po vazhdojnë pa respektimin e lejeve të ndërtimit të dhëna nga DUPH-ja, dhe ri-tenderimin e projektit që është nën hetime, situatë po aq kritike përshkruhet të jetë edhe në kampingun e Prevallës, ku sipas të dhënave të organeve komunale të Prizrenit kontrata e menaxhimit të kampingut ka skaduar që nga data 15 maj 2011.

EC Ma Ndryshe gjatë periudhës raportuese ka siguruar “Procesverbalin për Kampingun në Prevallë” të hartuar nga komisioni shtatë anëtarësh komunal i formuar me aktvendimin e kryetarit të komunës, Ramadan Muja. Të gjeturat e komisionit, që janë përshkruar në procesverbalin e hartuar pas pesë takimesh, dëshmojnë për gjendjen skandaloze dhe alarmante në këtë kamping.

Gjatë vizitave në terren, komisioni komunal ka vërejtur defekte të shumta, si në vijim:

1. Tejkallimet në natyrën e objekteve për kampingje të përkohshme;
2. Tejkallimet në numrin e objekteve të planifikuara;
3. Materialet ndërtimore të përdorura jashtë standardeve për kampingje të përkohshme;
4. Tejkallimet në gabarit dhe në etazhitet në objektet e ndërtuara;
5. Sistemi i rrymës dhe shpërndarja e saj nëpër kamp jashtë normave, që paraqet rrezik permanent për banorët e kampingut;
6. Sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit jashtë kushteve minimale higjienë-sanitare dhe nuk plotëson asnjë kriter për shfrytëzim dhe përdorim;
7. Infrastruktura rrugore brenda dhe jashtë kampingut e papërfunduar
8. Restoranti me përmasa dhe shtrirje shumë e madhe për nevojat e banorëve të kampingut.

Komisioni i përbërë nga anëtarët e shtatë drejtorive, duke analizuar Planin Rregullativ të Prevallës ka konstatuar se kampingu në Prevallë nuk ekziston dhe ka rekomanduar se i njëjti duhet të mbyllet dhe të kthehet në gjendjen e mëparshme. Komisioni po ashtu ka theksuar se duke i marrë parasysh sugjerimet e MMPH-së dhe të Parkut Nacional “Malet e Sharrit”, kjo zonë është e veçantë dhe aty nuk lejohen ndërhyrjet në degradimin e mëtutjeshëm. Komisioni ka argumentuar se mbrojtja e kësaj zone është e rregulluar me ligjet në fuqi dhe se nuk mund të merret asnjë veprim tjetër.

Komuna e Prizrenit bashkë me MMPH-në kanë hartuar Planin Rregullativ “Fshati turistik në Prevallë”, që ishte miratuar nga KK-ja e Prizrenit, më 22 qershor 2006. Gjatë zbatimit të këtij

Plani Rregullativ sipas procesverbalit të komisionit ishte paraqitur nevoja e zhvendosjes së shfrytëzuesve të paorganizuar në ngastrën e KK-së, ku sipas planit parashihet të ndërtohen restoranti dhe parkingu. Zhvendosja dhe organizimi i tyre ishte menduar që të realizohet sipas planit të caktuar, për të cilën pas shpalljes së tenderit ishte lidhur kontrata me Operatorin Ekonomik "IS Company", e përtërirë më 15 maj 2009, e që ka skaduar më 15 maj 2011.

Bazuar në vëzhgimin e monitoruesve të EC Ma Ndryshe, zyrtarët e lartë të Qeverisë Komunale nuk i kanë kundërshtuar të gjeturat e komisionit. Mospajtimet e tyre kanë pas të bëjnë vetëm me hapat që duhen ndjekur tani e tutje.

EC Ma Ndryshe, gjatë monitorimit ka vërejtur dy momente kontradiktore të veprimit të pushtetit lokal, që përmenden në procesverbalin e komisionit komunal. Derisa në pjesën hyrëse të raportit thuhet se: "gjatë zbatimit të këtij Plani Rregullativ është paraqitur nevoja e zhvendosjes së shfrytëzuesve të paorganizuar në ngastrën e KK-së, ku sipas planit parashihet të ndërtohen restoranti dhe parkingu", te pjesa e rekomandimit thuhet qartë se: "duke analizuar Planin Rregullativ të Prevallës 'kampingu në Prevallë' nuk ekziston dhe i njëjti duhet të mbyllet dhe të kthehet në gjendjen e mëparshme".

Prandaj, EC Ma Ndryshe konstaton se krijimit të kësaj gjendjeje i ka kontribuar edhe pushteti lokal, me "tolerancën" që ka treguar në mos zbatimin e përpiktë të Planit Rregullativ dhe mos përfilljen e vërejtjeve dhe sugjerimeve të MMPH-së dhe të Parkut Nacional "Malet e Sharrit".

Duke i marrë për bazë të gjitha këto të dhëna, EC Ma Ndryshe rekomandon kryetarin e komunës, drejtorinë e DUPH-së dhe KK-në që të ndërmarrin veprime energjike dhe të menjëhershme për mbrojtjen e kësaj zone nga degradimi i mëtutjeshëm.

EC Ma Ndryshe vlerëson se është koha e fundit që kryetari dhe organet komunale të respektojnë Planin Rregullativ të "fshatit turistik Prevala" dhe ta zbatojnë atë në përpikëri, pa asnjë lloj improvizimi.

EC Ma Ndryshe fton kryetarin e komunës që të dëshmoj leadership dhe të vihet në krye të nismës për ndalimin e shkatërrimit të kësaj trashëgimie natyrore, nga ndërtimet e shumta pa leje dhe kampingu skandaloz.

EC Ma Ndryshe përkujton edhe MMPH-në se si bashkë-hartuese e Planit Rregullativ për Prevallën ka përgjegjësi shtesë për zbatimin e përpiktë të tij dhe kërkon përfshirje sa më të shpejtë të MMPH-së për ndalimin e masakrës urbane e mjedisore në Prevallë.

EC Ma Ndryshe inkurajon edhe organet e drejtësisë që të vazhdojnë si dhe të zgjerojnë hetimet e nisura në lidhje me dyshimet për shkeljet ligjore në fshatin turistik Prevallë, në mënyrë që çdo veprim jashtëligjor të adresohet në gjyqësor.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, [www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org).

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren  
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy  
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit" prej muajit shtator 2012  
përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*